



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P 496/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.11.2020 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Modifikimi i dokumentave standarte të tenderit për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF- 74446-10-08-2020, me objekt “*Blerje të mjeteve mjeksore veterinare*”, me fond limit 12,554,650 lekë pa tvsh, publikuar më datë 09.10.2020 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.

**Ankimues:** “Almedical” shpk  
Adresa: Rruga “Shefqet Musaraj”, Banesa nr. 17, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor** Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.  
Adresa: Rruga “Abdi Toptani”, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 09.10.2020 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF- 74446-10-08-2020, me objekt “*Blerje të mjeteve mjeksore veterinare*”, me fond limit 12,554,650 lekë pa tvsh, publikuar më datë 09.10.2020 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.

II.2. Në datën 13.10.2020, operatori ekonomik “*Almedical*” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë:

*Kompania “Almedical” shpk, nje kompani me eksperience ne tregun e materialeve dhe pajisjeve mjeksore dhe laboratorike, kiteve, reagenteve etj, sikurse ka marre pjese dhe ka realizuar me sukses shume kontrata me Autoritete te ndryshme kontraktore, eshte e interesuar per te marre pjese edhe ne kete prokurim, qe zhvillohet nga ana e institucionit tuaj.*

*Pas shqyrtimit me kujdes te Dokumentave Standart te Tenderit mbi kriteret ligjore dhe teknike, kompania jone veren disa kriteret qe bien ne kundërshtim me qellimet e Ligjit te Prokurimeve Publike, Ligji nr. 9643 dt 20.11.2006 neni 1 pikat 2 c), 2 ç), 2d):*

*c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedural e prokurimit publik:*

*c) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike:*

*d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jo diskriminues per te gjithë operatoret ekonomike. pjesemarrës ne procedurat e prokurimit publik.*

*Keshtu, shoqeria "Almedical" shpk duke pasur si qellim te marre pjese ne kete procedure, parashtron ankesen bazuar ne Ligjin nr 9643 dt.20.11.2006 dhe VKM Nr. 914. date 29.12.2014 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" si me poshte:*

*- Ne piken 2.1, pika 1 per Kapacitetin ligjor te operatoreve ekonomike eshte kerkuar:*

*1. Licenca leshuar nga autoritet perkatese, ku te jete e specifikuar kategoria per prodhim apo tregtim te barnave per kafshe.*

*Kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor eshte diskriminues dhe pengon nxitjen e pjesmarrjes se operatoreve ne kete procedure prokurimi, i cili eshte qellimi i LPP-se sipas nenit 1 pika c) e ketij ligji:*

*c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik.*

*Sipas nenit 5 pika 1 e ligjit nr 10081 date 23.02.2009 "Per Licencat Autorizimet dhe Lejet ne Republikën e Shqiperise"*

*1. Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve ne territorin e Republikës se Shqiperise jane, si rregull, te lira dhe nuk i nenshtrohen licencimit apo autorizimit, pervecse kur parashikohet ndryshe me ligj.*

*Sipas nenit 15 Pika 1:*

*1. Licencat dhe lejet, sipas fushave dhe kategorive ne kornpetence te institucioneve qendrore parashikohen ne shtojcen qe i bashkelidhet ketij ligji dhe eshte pjese perberese e tij.*

*dhe sipas kesaj shtojce (bashkengjitur kesaj ankese). Fusha II per Ushqimin dhe Shendetin licence kerkon vetem prodhimi i tregtimi i barnave per njerez apo kafshe.*

*Sipas legjislacionit ne fuqi, artikujt objekt kesaj kontrate nuk perfshihen ne kategoria e artikujt qe kerkojne licence per tregtimin e tyre, sepse jane materiale mjekesore.*

*Bazuar ne ligjin nr Nr. 9643. date 20.11.2006 i ndryshuar neni 20 "Autoritetet kontraktore duhet te shmangin cdo kriter kerkese apo procedure, qe lidhet me kualifikimin e operatoreve ekonomike, qe perben diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktoreve ose ndaj kategorive te tyre.*

*Kompania jone nepermjet kesaj ankese kerkon qe kjo pike per licencen te hiqet ose te ndryshohet ne: Operatoret Ekonomike duhet qe te kene te perfshire nefushen e tyre te veprimtarise tregtimin e artikujve objekt te ketij tenderi.*

*Gjithashtu ne piken 2.3 per kapacitetin teknik eshte kerkuar : Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese ne ditën dhe oren e hapjes se ofertave mostra per artikujt e meposhtem.*

*Mostrat duhet te kene date skadence te vlefshme nga dita e hapjes se ofertave deri ne dhjetor 2021.*

*Kriteri i vendosur nag AK perseri eshte diskriminues sipas nenit 27 pika 6:*

*Autoriteti kontraktor mund t'u kerkoje operatoreve ekonomike te dorezojne deshmi, qe tregojne se ata i plotesojne kerkesat minimale, te percaktuara ne dokumentet e tenderit, si: a) mostra te mallit kur e gjykon se kjo ka rendesi per vleresimin e ofertes teknike. Mostrat duhet te trajtohen si informacion konfidencial tregtarm dhe duhet te jene ne kontroll te autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kerkesen e tij 30 (tridhjete) dite pas nenshkrimit te kontrates, ....*

*Mostrat do ti sherbejne AK per ti verifikuar ne momentin e dorezimit te ofertave dhe vleresimit te ofertave teknike dhe do ti kthehen operatoreve pas nenshkrimit te kontrates prandaj kerkesa qe afati i skadences per mostrat te jete deri ne dhjetor te 2021 eshte diskriminues .*

*Kompania jone kerkon qe kjo pike te ndryshohet ne: Mostrat duhet te kene date skadence te vlefshme nga dita e hapjes se ofertave deri ne mars 2021.*

II.2.1. Në datë 15.10.2020 me shkresën nr 1820/1 prot, pala ankimuese operatori ekonomik “Almedical” shpk ka marrë dijëni në lidhje me mospranimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor:

II.2.2. Në datën 21.10.2020 operatori ekonomik “Almedical” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor.

II.3. Me shkresën me nr. 1905/1 prot, datë 29.10.2020, protokolluar me tonën me nr. 1318/2 prot, datë 29.10.2020, me objekt “Informacion” është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Almedical” sh.p.k. për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, sipas argumentimit si më poshtë vijon: “Shoqeria “Almedical” shpk duke pasur si qellim te marre pjese ne kete procedure, parashtron ankesen bazuar ne Ligjin nr 9643 dt.20.11.2006 dhe VKM Nr. 914. date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” si me poshte: Ne piken 2.1,

pika 1 per Kapacitetin ligjor te operatoreve ekonomike eshte kerkuar: 1. Licenca leshuar nga autoritet perkatese, ku te jete e specifikuar kategoria per prodhim apo tregtim te barnave per kafshe. Kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor eshte diskriminues dhe pengon nxitjen e pjesmarrjes se operatoreve ne kete procedure prokurimi, i cili eshte qellimi i LPP-se sipas nenit 1 pika c) e ketij ligji. Sipas nenit 5 pika 1 e ligjit nr 10081 date 23.02.2009 "Per Licencat Autorizimet dhe Lejet ne Republiken e Shqiperise". "1. Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve ne territorin e Republikes se Shqiperise jane, si rregull, te lira dhe nuk i nenshtrohen licencimit apo autorizimit, pervecse kur parashikohet ndryshe me ligj". Sipas nenit 15 Pika 1: "1. Licencat dhe lejet, sipas fushave dhe kategorive ne kornpetence te institucioneve qendrore parashikohen ne shtojcen qe i bashkelidhet ketij ligji dhe eshte pjese perberese e tij". dhe sipas kesaj shtojce (bashkengjitur kesaj ankese). Fusha II per Ushqimin dhe Shendetin licence kerkon vetem prodhimi i tregtimi i barnave per njerez apo kafshe. Sipas legjislacionit ne fuqi, artikujt objekt kesaj kontrate nuk perfshihen ne kategorine e artikujt qe kerkojne licence per tregtimin e tyre, sepse jane materiale mjekesore. Kompania jone nepermjet kesaj ankese kerkon qe kjo pike per licencen te hiqet ose te ndryshohet ne: Operatoret Ekonomike duhet qe te kene te perfshire nefushen e tyre te veprimtarise tregtimin e artikujve objekt te ketij tenderi. ", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 9/2, "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit", në pikën 2.2.1 "Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomik" nga ana e autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë:

- "Licenca lëshuar nga autoritet përkatëse, ku të jetë e specifikuar kategoria për prodhim apo tregtim të barnave per kafshë".

III.1.2. Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;" .

III.1.3. Në Ligjin Nr. 10081, datë 23.2.2009 "Per Licencat, Autorizimet dhe Lejet Në Republikën E Shqipërisë", Shtojce e ligjit "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", parashikohet:

*Fusha II.*

*Ushqimi dhe Shëndeti*

1. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve
2. Licence Shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinare
3. Licence Rritja ose tregtimi i kafshëve

4. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i farërave dhe/ose fidanëve
5. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve
6. Licence Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë
7. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë.
8. Licence Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjiëno-sanitare.

III.1.4. Në VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, parashikohet:

## **FUSHA II USHQIMI DHE SHËNDETI**

### **KATEGORIA II.7**

#### **PRODHIMI DHE/OSE TREGTIMI I BARNAVE PËR NJERËZ OSE KAFSHË**

##### **I. NDARJA E KATEGORISË DHE RREGULLA TË PËRGJITHSHME**

1. Veprimtaria e “Prodhimit dhe/ose tregtimit të barnave (për njerëz ose kafshë)” është kategoria II.7 e shtojcës së ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.
2. Kategoria e kësaj veprimtarie ndahet në tre nënkategori si vijon:
  - a) “Farmacitë ose agjencitë farmaceutike” me kodin II.7.A;
  - b) “Tregtimi me shumicë i barnave”, me kodin II.7.B;
  - c) “Prodhimi i barnave”, me kodin II.7.C.
3. Licencat e nënkategorive të kategorisë A, B dhe C, janë pa afat
4. Veprimtaritë e nënkategorive A, B, C specifikohen në:
  - a) Barna për njerëz. Kodit përkatës i shtohet në fund numri 1;
  - b) Barna për kafshë. Kodit përkatës i shtohet në fund numri 2..

##### **III. BARNAT PËR KAFSHË**

12. Kriteret e posaçme të licencimit, si dhe llojet e dokumenteve provuese e shoqëruese përkatëse lidhur për barnat për kafshë për të tre nënkategorinë A, B dhe C janë të ngjashme me ato të barnave për njerëz sipas anekseve respektive të këtij vendimi.
13. Grupet dhe procedurat e licencimit për barnat për kafshë është e njëjtë me atë të barnave për njerëz sipas të njëjtave nënkategori me ndryshimin që:
  - a) në rastin e nënkategorive B dhe C institucioni tjetër është Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, vendimin në emër të së cilës e merr Drejtoria e Veterinarisë;
  - b) drejtuesi teknik në rastin e nënkategorive A dhe B duhet të ketë profesionin veteriner.
14. Veprimtaritë e prodhimit e tregtimit të barnave për kafshë licencohen më veçmas atyre të barnave për njerëz.

##### **IV. DATA E FILLIMIT TË LICENCIMIT SIPAS KËTIJ VENDIMI**

15. Licencimi i veprimtarive sipas këtij vendimi fillon më datë 9.6.2009.

III.1.5. Në nenin 4 “Përkufizimet”, pika 87 e Ligjit 10465/2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë” parashikohet shprehimisht se:

*Produkt mjekësor veterinar (më poshtë PMV)” është çdo lëndë ose përzierje lëndësh:*

*a) që përdoren për mjekimin ose parandalimin e sëmundjes në kafshë;*

*b) që mund t’u jepet kafshëve për të kthyer, rregulluar ose ndryshuar funksionet fiziologjike në kafshë, duke ushtruar një veprim farmakologjik, imunologjik ose metabolik apo për vendosjen e një diagnoze mjekësore.*

III.1.6. Në Kreun VII “Produktet Mjekësore Veterinare”, Seksioni 1 “Autorizimi për tregtimin e produkteve mjekësore veterinar”, në nenin 85 “Tregtimi i produkteve mjekësore veterinar”, të Ligjit 10465/2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë” parashikon shprehimisht se:

*1. Produktet mjekësore veterinar, dezinfektantët dhe dezinfestantët për përdorim veterinar tregtohen në Republikën e Shqipërisë, vetëm pasi të jenë miratuar nga Komisioni Shtetëror i PMV-ve, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren përkatëse të PMV-ve, të miratuar nga ministri. Deratizuesit lejohet të tregtohen në Republikën e Shqipërisë, pas regjistrimit, sipas legjislacionit në fuqi.*

*2. Kur një produkt mjekësor veterinar lejohet për tregtim në Republikën e Shqipërisë, sipas pikës 1 të këtij neni, atëherë lejohet të tregtohen edhe variacionet dhe shtesat e këtij produkti, që kanë të bëjnë me llojet e tjera të kafshëve, ku mund të përdoren, me përqendrimin, formën farmaceutike, rrugët e përdorimit e me paraqitjen, sipas procedurave të rregullores përkatëse të PMV-ve.*

*3. Komisioni Shtetëror i PMV-ve njih dhe pranon certifikatën e tregtimit për PMV-të, lëshuar nga Agjencia Europiane e Medikamenteve (EMA) ose në një nga vendet e BE-së.*

*4. Autoriteti kompetent lëshon certifikatën e tregtimit për secilin produkt të miratuar, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e miratimit prej komisionit. 5. Produktet e miratuara nga Komisioni Shtetëror i PMV-ve shënohen në regjistrin zyrtar të PMV-ve.*

*6. Ministri, në rastet e një gjendjeje të rëndë shëndetësore ose epidemiologjike, me propozimin e Komisionit Shtetëror të PMV-ve, urdhëron lejimin e përkohshëm të tregtimit ose të përdorimit në kafshë të PMV-ve të autorizuara në një nga vendet anëtare të BE-së, në përputhje me legjislacionin përkatës.*

III.1.7. Në nenin 92 “Prodhimi i PMV-vë në vend”, në Seksionin II “Prodhimi, Importimi dhe Tregtimi i PMV-vë” në Ligjin 10465/2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë” parashikohet shprehimisht se:

*1. Veprimtaria e prodhimit të PMV-ve në vend kryhet sipas legjislacionit në fuqi.*

*2. Licenca e prodhimit të PMV-ve u jepet subjekteve që kryejnë njëkohësisht ose në mënyrë të veçantë veprimtari të tilla si: ndarjen, shtypjen e tabletave, paketimin, përzierjen ose prodhimin e lëndëve aktive.*

*3. Ministri miraton procedurat e prodhimit të PMV-ve.*

III.1.8. Referuar kriterit të kualifikimit rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë të provojnë se disponojnë ambjente për ushtrimin e veprimtarisë së

shëbimit të lavanterisë për realizimin e kontratës si më sipër cituar. Për të provuar këto kapacitete operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë – *“Licenca lëshuar nga autoritetet përkatëse, ku të jetë e specifikuar kategoria për prodhim apo tregtim të barnave per kafshë”*.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse përsa i përket fushës së zbatimit për rastin konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.1.10. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së. Komisioni i Prokurimit Publik thekson se, autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës të mirëmenaxhimit të fondeve publik (në zbatim të nenit 12 të LPP-së) është njëherazi përgjegjës për ndjekjen e të gjithë hapave të procedurës së prokurimit duke përfshirë edhe hartimin e kriterëve të kualifikimit.

III.1.11. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *“2. Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”*

III.1.12. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në përcaktimin/apo vendosjen e kriterëve ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: *(i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të*



*prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.*

III.1.13. Sa më sipër, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, argumentimi i autoritetit si dhe referuar legjislacionit të fushës përkatëse VKM 538, datë 26.05.2009 “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa Rregullime të tjera nënligjore të Përbashkëta”, konstatohet se në Fushën II Ushqimi dhe Shëndeti, parashikohet se “Për veprimtarinë prodhim ose tregtim i barnave për njerëz ose kafshë”, Barnat për Kafshë “Kriteret e posaçme të licencimit, si dhe llojet e dokumenteve provuese e shoqëruese përkatëse lidhur për barnat për kafshë për të tre nënkategorinë A, B dhe C janë të ngjashme me ato të barnave për njerëz sipas anekseve respektive të këtij vendimi. Veprimtaritë e prodhimit e tregtimit të barnave për kafshë licencohen më veçmas atyre të barnave për njerëz”. Nga shqyrtimi në tërësi i mallrave objekt prokurimi, Komisioni gjykon se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me barna për kafshë në preventiv në kuptim të ligjit të sipërcituar, ndaj dhe kërkesa e autoritetit kontraktor në lidhje me disponimin e “Licenca lëshuar nga autoritet përkatëse, ku të jetë e specifikuar kategoria për prodhim apo tregtim të barnave për kafshë”, nuk është e domosdoshëm dhe nuk është në proporcion me objektin, llojin dhe specifikat e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe në tejkalim të kontratës objekt prokurimi dhe të dispozitave ligjore përkatëse, duke patur parasysh kushtet dhe specifikat e procedurës. Komisioni Prokurimit Publik vlerëson se, kriteri i sipërcituar nuk është hartuar tërësisht në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, dhe legjislacionin specifik pasi ka kufizuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke përjashtuar kështu operatorë të tjerë ekonomikë të cilët edhe pse mund të garantojnë zbatimin e kontratës. Për sa më sipër në kuadër të mosdiskriminimit dhe krijimit të lehtësirave për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e kriterit lidhur me kërkesën e mësipërcituar.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Almedical” shpk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Almedical” sh.p.k. për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, me argumentin si më poshtë vijon: “Gjithashtu në piken 2.3 për kapacitetin teknik është kërkuar : Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë në ditën dhe orën e hapjes së ofertave mostra për artikujt e mëposhtëm. Mostrat duhet të kenë date skadence të vlefshme nga dita e hapjes së ofertave deri në dhjetor 2021. Kriteri i vendosur në AK perseri është diskriminues sipas nenit 27 pika 6. Autoriteti kontraktor mund t’u kerkojë operatorëve ekonomike të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të percaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtarm dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, .... Mostrat do të shërbejnë AK për të verifikuar në momentin e dorëzimit të ofertave dhe vlerësimin të ofertave teknike dhe do të kthehen operatorëve pas nënshkrimit të kontratës

prandaj kërkesa që afati i skadencës për mostrat të jetë deri në dhjetor të 2021 është diskriminues”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1 Në dokumentat e tenderit, shtojca 9/2, “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, në pikën 2.3 “Kapaciteti teknik” nga ana e autoriteti kontraktor është përcaktuar si më poshtë:

“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë në ditën dhe orën e hapjes së ofertave mostra për artikujt e mëposhtëm. Mostrat duhet të kenë datë skadencë të vlefshme nga dita e hapjes së ofertave deri në dhjetor 2021. Afati i skadencës së mallrave ditën e dorëzimit nga operatori ekonomik fitues të jetë jo më pak se 1 (një) vit”.

<b>Nr</b>	<b>Përshkrimi i mallrave</b>	<b>Njësia</b>
1	Shiringa 2 cc	copë
2	Shiringa 5 cc	copë
3	Shiringa 20 cc	copë
4	Age G19	copë
5	Vigona ngjyrë e verdhë 24 g	copë
6	Aparat serumi	copë
7	Doreza Sterile Nr. 7, Nr. 7.5, Nr. 8	copë
8	Doreza jo Sterile Nr. 7, Nr. 7.5, Nr. 8	copë
9	Suture USP Nr.1 PGA+age	copë
10	Bisturi Nr.21	copë
11	Garza Sterile 10*10 cm	copë
12	Mbulesa një përdorim sterile	copë
13	Matrikuj për qen	copë
14	Përparëse operimi një përdorimshe	copë
15	Doreza për kapjen e qenve	copë
16	Lak special për kapjen e qeneve 150cm, kavo çeliku i mbuluar me plastikë me mekanizëm me sustë	copë
17	Qese 1 m * 70 cm	kg
18	Maska operacioni një përdorimëshe	copë
19	Pinca Hemostatike	copë
20	Mushama shiu	copë
21	Gjilpëra atraumatike	copë
22	Ushqim qeni 21 % proteinë + 9% yndyrë	kg
23	Fipronil 134 mg 10-20 kg	copë
24	Qafore antiparazitare deltamethrine 4% p/p	copë
25	Portage	copë
26	Darë matrikullimi	copë
27	Pinceta me dhëmbë	copë

III.2.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë

*pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”.*

III.2.3. Në nenin 27 “Kontratat e Mallrave”, pika 3, e VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve”. Ndërsa në pikën 6, po këtu, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike;dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.

III.2.4. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.2.5. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorëve ekonomikë ankimues, mbi modifikimin e kriterit të veçantë të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së. Komisioni i Prokurimit Publik thekson se, autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës të mirëmenaxhimit të fondeve publik (në zbatim të nenit 12 të LPP-së) është njëherazi përgjegjës për ndjekjen e të gjithë hapave të procedurës së prokurimit duke përfshirë edhe hartimin e kriterëve të kualifikimit.

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *“2. Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efijencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.*

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në përcaktimin/apo vendosjen e kriterëve ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) *në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet* dhe (ii) *jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve*. Mostra, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të siguruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Në rastin konkret, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor që mostrat duhet të kenë datë skadence të vlefshme nga dita e hapjes së ofertave deri në dhjetor 2021 është një kërkesë diskriminuese dhe joproporcionale me natyrën e kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik në ditën e hapjes së ofertave të jenë të vlefshme. Për sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin duke hequr afatin deri në dhjetor 2021, kjo në funksion të hapjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundësëm në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

III.2.8. Akoma më tej, K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor ka në dispozicion edhe momentin procedural të kontrollit *ex post-pas lidhjes së kontratës* të përpuethshmërisë dhe vlefshmërisë së produkteve të furnizuara nga operatori ekonomik i kualifikuar me ato të

kërkuar nga autoriteti kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në bazë të nenit 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës” të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor nuk është proporcionale me objektin e procedurës së prokurimit, natyrën, përmasat e kontratës si edhe me qëllimin e kërkuar nga vetë autoriteti kontraktor. K.P.P. gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë dokumentet e procedurës së prokurimit në përputhje me konstatimet e mësipërme.

Për rrjedhojë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Almedical” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF- 74446-10-08-2020, me objekt “Blerje të mjeteve mjeksore veterinarë”, me fond limit 12,554,650 lekë pa tvsh, publikuar më datë 09.10.2020 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.
  2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentat e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
  3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
  4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë ankimues “Almedical” sh.p.k.
  5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1318 Protokoli, Datë 21.10.2020**

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**